



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 125/ Prot.

Tiranë, më 19.05.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datë 19.05.2020, ditën e martë, ora 10.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në platformën online, përmes lidhjes Zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Këshilli u mbledh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimi
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Znj. Nurihan Seiti
5. Z. Tartar Bazaj
6. Z. Bujar Sheshi
7. Z. Kosta Beluri
8. Z. Sandër Beci
9. Z. Vatë Staka

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z.Gent Ibrahimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme dhe emërimin e tyre në detyrë”.



Z. Ibrahim vë në dukje se mbledhja e sotme është në vazhdim të mbledhjes së mëparshme, ku ne zhvilluam intervistat me katër kandidatët për tre pozicione vakante për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme.

Sikurse e dini, (në mbledhjen e datës 15 maj 2020) ne vendosëm bashkimin e dy procedurave administrative në një të vetme, gjë që do t'i mundësonte Këshillit shqyrtimin e katër kandidaturave, njëkohësisht. Për rrjedhojë, Këshilli sot pritet të miratojë katër projektvendime: një - për miratimin e listës së prokurorëve, renditur sipas sistemit të pikëzimit; më pas, miratimin e tre projektvendimeve individuale për emërimin në detyrë të secilit prej tyre, si Prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Nuk ka.

Kryetari parashtron, ndërkohë, propozimin për përfshirjen në rendin e ditës të projektaktit për miratimin e pjesëmarrjes së listës së prokurorëve në trajnimet e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës.

Kjo është një kompetencë që Këshilli e ushtron në mënyrë periodike, duke miratuar/dhënë leje edhe për listën e pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnimet vazhduese, edhe për temat përkatëse që ata do të ndjekin pranë Shkollës së Magjistraturës, konkretisht gjatë periudhës Prill-Qershor 2020.

Për shkak të vonesave në punën e Këshillit, shkaktuar nga gjendja e pandemisë, ne nuk arritëm ta miratonim këtë projektakt sipas afatit (fundi i Marsit). Megjithatë, duke qenë se Shkolla e Magjistraturës ka vijuar me trajnimet online dhe ka marrë vendim për t'i përfunduar trajnimet gjatë muajit qershor, është e rëndësishme që Këshilli të marrë sot një vendim për miratimin e kësaj liste.

Z. Ibrahim pyet paraprakisht anëtarët, nëse pajtohen për ta shtuar këtë pikë në rendin të ditës dhe pasi merr miratimin e tyre, e hedh në votim.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit si më poshtë:

Në zbatim të neneve 159 pika 2, germa "e", nenit 186, germat "a", "b" dhe "c", nenit 189, pika 1 germa "c", nenit 272, pikat 1 deri 3 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; nenit 5, pika 1, 2, 3, 5 dhe 6 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; bazuar në korrespondencën me Shkollën e Magjistraturës dhe në relacionin e përgatitur nga Komisioni për Vlerësimin e Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, KLP vendosi:



1. Të miratojë pjesëmarrjen e listës së prokurorëve në trajnimet e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën prill-qershor 2020.
2. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës dhe magjistratët prokurorë, sipas listës dhe kalendarit të propozuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim i rikthehet diskutimit të pikës kryesore, siç ishte parashikuar në rendin e ditës.

- *Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme dhe emërimin e tyre në detyrë”.*

Z. Ibrahim informon se Komisioni i Posaçëm, ngritur në zbatim të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” (SPAK), miratuar nga Këshilli me Vendimin nr.51, datë 19.03.2019, ka vijuar punën për rreth dy muaj dhe ka përgatitur një relacion. Për të relatuar në emër të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, i jepet fjala z.Beci.

Z. Beci e nis relatimin, duke iu referuar faktit se në listën fillestare prej 15 emrash që KLP i kishte renditur si kandidatë për prokurorë pranë SPAK, si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, u krijuan dy pozicione vakante. Për të plotësuar këto dy vende, më 28.01.2020, Këshilli publikoi në faqen e tij zyrtare thirrjen për të gjithë prokurorët që plotësonin kriteret e vendosura, të cilët mund të aplikonin brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike. Afati përfundonte më 12.02.2020, datë kur paraqitën kandidaturat e tyre z.Vladimir Mara, z. Dritan Prençi dhe z. Sotir Kllapi.

Në mbledhjen e datës 24.02.2020, me Vendimin nr.54, Këshilli miratoi ndryshimin e Vendimit nr.19, datë 27.01.2020, duke zgjatur afatin për aplikim nga “jo më vonë se 15 ditë kalendarike”, në “jo më vonë se 40 ditë kalendarike”. Për pasojë, afati i fundit u caktua data 08.03.2020, duke synuar konkurrencën në garë.

Nga ana e KLP-së, më datë 26.02.2020 u përsërit për herë të dytë thirrja për dy vende vakante. Në përfundim të afatit aplikoi edhe kandidatja tjetër, znj. Dorina Bejko.

Më datë 02.04.2020, pranë KLP-së është depozituar dorëheqja e një kandidati të renditur në listën fituese prej 15 kandidaturash. Për këtë arsye, në faqen zyrtare të Këshillit, më datë 10.04.2020 është shpallur thirrja për të aplikuar për plotësimin e një vendi vakant. Për këtë pozicion kanë aplikuar z. Sotir Kllapi dhe znj. Dorina Bejko.



Në përfundim të afatit, për tre vende vakante kanë kandiduar katër prokurorë dhe konkretisht: z. Vladimir Mara, z. Dritan Prençi, znj. Dorina Bejko dhe z. Sotir Kllapi.

Me Vendimin nr. 113, datë 15.05.2020, KLP bëri bashkimin e dy procedurave administrative të filluara mbi bazën e vendimeve nr.19, datë 27.01.2020 dhe nr.92, datë 10.04.2020, duke vendosur që vlerësimi përfundimtar dhe renditja e katër kandidatëve të kualifikuar të ishte e vlefshme për plotësimin e tre vendeve vakante pranë Prokurorisë së Posaçme.

Pas verifikimit paraprak të kushteve ligjore, Komisioni i Posaçëm pranë KLP-së vlerësoi se të katër kandidatët i plotësonin kriteret ligjore dhe, me Vendimin nr.84, datë 18.03.2020, miratoi listën me kandidatët e sipërcituar, duke bërë vlerësimin e kriterëve të posaçme etike dhe profesionale të secilit prej tyre.

Komisioni ka kryer një punë intensive për vlerësimin sasior dhe cilësor të kandidatëve lidhur me aftësitë profesionale, vendosmërinë, qëndrueshmërinë dhe integritetin, manifestuar këto në aktet e procedimeve penale që ata paraqitën për të argumentuar dhe dokumentuar meritat e tyre, përkatësisht sipas kërkesave të nenit 9 dhe nenit 10 të Rregullores. Gjatë këtij procesi Komisioni ka punuar edhe në prani të përfaqësuesve të OPDAT e EURALIUS, përmes platformës online në lidhje Zoom.

Raportet e vlerësimit dhe gjithë dokumentacioni (letrat e motivimit, aktet e procedimeve penale dhe pasurore etj.) janë vënë në dispozicion të Komisionit të Posaçëm. Komisioni, pasi ka vendosur se cilat akte të administruara do të merrte ose jo në konsideratë, në përfundim të punës së tij ka arritur në vlerësimin e kandidatëve, referuar përkatësisht kërkesave të nenit 9 (kriteri profesional) dhe kërkesave të nenit 10 (kriteri i integritetit) të Rregullores. (*Relacioni i plotë ndodhet në dosjen e seancës pranë protokollit të KLP-së*).

Përfundimisht, Komisioni ka arritur në vlerësimet e mëposhtme:

1. Znj. Dorina Bejko: kualifikimi sipas nenit 9 - i lartë; kualifikimi sipas nenit 10 - i mesëm.
2. Z. Dritan Prençi: kualifikimi sipas nenit 9 - i lartë; kualifikimi sipas nenit 10 - i lartë.
3. Z. Sotir Kllapi: kualifikimi sipas nenit 9 - i lartë; kualifikimi sipas nenit 10 - i mesëm.
4. Z. Vladimir Mara: kualifikimi sipas nenit 9 - i lartë; kualifikimi sipas nenit 10 - i lartë.

Këto vlerësime përfundimtare janë paraqitur në formularin 1 të shtojcës A, si aneks i Rregullores, dhe u janë shpërndarë anëtarëve të Këshillit.

Z. Ibrahim falenderoi Komisionin për punën e kryer. Kjo, falë edhe metodologjisë së përpiktë të Rregullores së miratuar nga Këshilli, e cila po rezulton mjaft efektive për një vlerësim sa më objektiv e të paanshëm të kandidatëve, qoftë edhe për faktin se sistemi aktual i drejtësisë nuk rezulton të ketë mjaftueshëm filtra të mirëfilltë për të bërë sa më saktë të jetë e mundur, dallimin mes aftësive profesionale të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.



Sa i takon veprimtarisë profesionale sipas sistemit të mëparshëm të vlerësimit, kandidatët janë vlerësuar maksimalisht me 5 pikë; pra, në këtë garë ata futen të barabartë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Sheshi, i cili ka qëndrim të ndryshëm nga ai shumicës së Komisionit.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Sheshi pohon se Komisioni është mbështetur në raportet e vlerësimit të qëndrueshmërisë për çdo kandidat dhe, referuar rastit të znj. Dorina Bejko, ka vendosur me shumicë që ajo të vlerësohet me kualifikimin “niveli i mesëm”.

Referuar nenit 7, germa “p”, pika 4, nenit 10 të Rregullores, bazuar në praktikën e mëparshme dhe në standardin e vendosur për kandidatët për SPAK, të gjithë ata prokurorë që kanë patur dosje me subjekte “zyrtarë të lartë” do të trajtoheshin sipas germës “k”, neni 2 i Rregullores.

Për të ruajtur këtë standard, z. Sheshi argumenton që znj. Bejko duhej vlerësuar me kualifikimin “niveli i lartë”. Me këtë rast, referohet rasti i dosjes së një funksionari të lartë (Kryetar Komune), të trajtuar nga znj. Bejko. Sipas tij, znj. Bejko duhej vlerësuar maksimalisht edhe për anën profesionale, edhe për qëndrueshmërinë dhe integritetin.

Pasi referon një rast tjetër të trajtuar nga z. Kllapi, ai propozon përfundimisht që, si znj. Bejko, ashtu dhe z. Kllapi, të vlerësohen të dy me kualifikimin “niveli i lartë”. Për këtë shkak, z. Sheshi kërkon që Këshilli të rishikojë vlerësimet e Komisionit për këta dy kandidatë, duke saktësuar se është detyrë e Këshillit të marrë një vendim në shërbim të një gare të ndershme e në kushte të barabarta.

Z. Ibrahim i referohet nenit 15 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, ku parashikohen rastet, kur çështja ka ardhur për t’u miratuar në Këshill dhe ky i fundit duhet të vendosë për shkallën e vlerësimit të çdo kandidati.

Ai njofton Këshillin për ndërprerjen e mbledhjes plenare (për shkaqe teknike) dhe rikthehet pas disa çastesh, duke ia dhënë fjalën znj. Seiti.

Znj. Seiti konstaton se është hera e parë që Këshilli përballet me një ndryshim vendimi të Komisionit, konkretisht për renditjen e kandidatëve. Ajo komenton se qëndrimi i z. Sheshi solli dy risi: 1. Brenda Komisionit ka një opinion ndryshe nga shumica (edhe pse z. Sheshi e ka firmosur raportin); 2. Anëtarët e Këshillit mund të shprehin një opinion ndryshe nga ai i Komisionit.

Znj. Seiti pajtohet me z. Sheshi për interpretimin që ai i bën çështjes së dosjes së “funksionarit të lartë”, që znj. Bejko ka patur në shqyrtim. Ajo shpreh bindjen se të dy prokurorët (si znj. Dorina



Bejko, ashtu dhe z. Sotir Kllapi) meritojnë të vlerësohen maksimalisht, si për kriterin profesional, ashtu dhe për integritetin. Duhet marrë parasysh fakti se ata kanë kaluar provimin e vështirë të Shkollës së Magjistraturës dhe janë përballur gjatë punës së tyre edhe me dosje të komplikuar profesionalisht, edhe me presion të fortë psikologjik e social, duke jetuar e vepruar në një qytet të vogël.

Z. Bazaj shprehet se, pavarësisht pajtimit të tij me kualifikimin “niveli i mesëm” për kriterin e qëndrueshmërisë në rastin e z. Kllapi, tek ky i fundit prevalon ana profesionale (neni 9) si Drejtues i Prokurorisë; për më tepër që, sipas ligjit të vjetër, ai ka patur akses në të gjitha dosjet. Për mua, Z. Kllapi duhet të vlerësohet me kualifikimin “niveli i lartë”. Por, unë jam pajtuar me mendimin e Komisionit, për më tepër duke qenë në sy të ndërkombëtarëve që janë monitoruesit e këtij procesi.

Ai është pajtuar me kualifikimin “niveli i mesëm” (sipas nenit 10), duke qenë se prokurorët e rretheve nuk e kanë patur mundësinë për të dëshmuar atë shkallë të lartë qëndrueshmërie, sikundër mund ta kenë dëshmuar prokurorët e Krimeve të Rënda. Thënë hapur, rasti i një Kryetari Komune nuk mund të krahasohet me rastin e një Ministri të Brendshëm, për më tepër që kjo dosje përfundoi në gjykatë.

Ai paralajmëron se Këshilli duhet të jetë i kujdesshëm në lidhje me këtë çështje (pra, nuk mund të bëjë ndryshime në vendimin e Komisionit për të katër kandidaturat), pasi kjo mund të bëhet objekt në Gjykatën e Apelit nga ndonjë kandidat që nuk do të kalojë, dhe vendimi ynë si akt administrativ mund të rezultojë nul.

Teksa z. Bazaj flet, ndërhyjnë znj. Seiti, e cila e konsideron paragjykes qëndrimin e tij si anëtar Komisioni, dhe shprehet me tone tejet kritike për një “vendim gjykate” që ai sjell si argument në mbledhjen e Këshillit.

Z. Ibrahim ndërhyjnë dhe tërheq vëmendjen se asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk mund ta paragjykojë këtë proces, sa kohë që asnjë nga kandidatët nuk është paragjykuar nga Këshilli. Fundja, ky është një proces që mund të nxjerrë “prokuror në SPAK” cilindo nga katër kandidatët.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Beluri shprehet kundër mendimit të shumicës së Komisionit të Posaçëm, duke qenë i bindur se të dy kandidatët në fjalë (znj. Bejko dhe z. Kllapi) kanë dëshmuar nivel të lartë qëndrueshmërie dhe integriteti.

Sipas metodologjisë së parashikuar në Rregulloren, për të vlerësuar qëndrueshmërinë në kryerjen e detyrave, kandidatët referojnë pranë Komisionit rrethana ku ata kanë treguar profesionalizëm dhe etikë në trajtimin e dosjeve. Komisioni relatton se asnjë nga kandidatët nuk ka ofruar rrethana të tilla. Por, unë mendoj se kjo nuk e pengon Komisionin të kërkojë për rrethana të tilla, duke iu referuar dokumentacionit të depozituar dhe/ose të kërkuar prej kandidatëve.



Sa i takon vlerësimin të kriterit të vështirësisë apo qëndrueshmërisë, ai thotë se këtë nuk do e linte në dorë të shortit/fatit. Rasti i “zyrtarit të lartë” që u përdor këtu si argument integriteti, thjesht i ka rastisur kandidatit për arsye se ka punuar tre vjet tek Krimet e Rënda.

Nëse kandidatët që vijnë nga Krimet e Rënda, do t’i shikonim me syrin se sa dosje të vështira kanë trajtuar, kur kanë punuar prej shumë vitesh në rrethe, vlerësimi i Komisionit do të kishte qenë më objektiv.

Afërmendsh që prokurorët e Krimeve të Rënda do të merreshin me çështje të mprehta, pasi prokuroritë e rretheve nuk kanë patur kompetencë, fjala vjen, për konfiskimin e pasurisë apo të produkteve të veprave kriminale, në kuadër të ligjit antimafia.

Për këtë arsye, sipas z. Beluri, të dy kandidatët e sipërcituar (znj. Bejko dhe z. Kllapi) që kanë ardhur nga rrethet, nuk duhen kualifikuar me vlerësimin “niveli i mesëm”, por “niveli i lartë”.

Z. Beci merr shkas nga diskutimi i z. Beluri për të shpjeguar se në raportet e vlerësimit për dy kandidatët e ardhur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda janë administruar dosje ku dëshmohet mjaftueshëm vendosmëria, qëndrueshmëria dhe integriteti i tyre, edhe kur kanë pas punuar në rrethe. Pra, Komisioni ka konsideruar edhe pjesën tjetër të karrierës së tyre, përtej Krimeve të Rënda.

Znj. Seiti komenton se, kur shprehemi për vlerësimin “niveli i lartë” për znj. Bejko dhe z. Kllapi, ne nuk çënojmë dy kandidatët e ardhur nga Krimet e Rënda. Ata tanimë e kanë marrë vlerësimin e tyre dhe janë me kualifikimin “niveli i lartë”. Puna është që ne të jemi të drejtë edhe me dy prokurorët e juridiksionit të përgjithshëm, pasi në të ardhmen do të kemi përsëri raste të ngjashme nga rrethet.

Sa u takon fituesve të mundshëm, këtë e zgjidh vota, - thotë ajo.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e pozicionit të Komisionit për z. Kllapi dhe znj. Bejko, pra që të qëndrojnë në fuqi shkalla e kualifikimit “niveli i mesëm”.

Nuk miratohet, pasi merr vetëm 4 vota pro: z. Balla, z. Bazaj, z. Beci, z. Staka.

Z. Ibrahim hedh në votim propozimin për ndryshimin e shkallës së kualifikimit për z. Kllapi dhe znj. Bejko, nga “niveli i mesëm”, në “niveli i lartë”.

Miratohet me 5 vota pro.

Z. Ibrahim hedh në votim edhe pozicionin e Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale, për të cilin nuk pati kontestime.

Miratohet me 9 vota pro.



Z. Ibrahim njofton se, meqë të gjithë kandidatët u rivendosën në pozicione të barabarta, tani është radha e aplikimit të sistemit të pikëzimit, duke zbatuar metodologjinë e përshkruar në shtojcën B të Rregullores.

Kryetari ndërpreu mbledhjen për kohësisht, për ta rifilluar pas përfundimit të procesit të pikëzimit, të kryer nga secili anëtar i Këshillit, nga i cili rezultoi se kandidatët u vlerësuan duke u renditur përkatësisht:

Sotir Kllapi - 174 pikë.

Dritan Prençi - 171 pikë.

Vladimir Mara - 168 pikë.

Dorina Bejko - 158 pikë.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit:

Në bazë të nenit 149/a të Kushtetutës; nenit 7 të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; të nenit 47/1/b dhe nenit 48/1, të ligjit nr 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 164/8, 166/2, 189/1/a të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; si dhe nenit 16 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, miratuar me Vendimin nr.51, datë 19.03.2019;

Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi:

1. Të miratojë listën me renditjen e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Rënditja e kandidatëve është si më poshtë:

1. Sotir Kllapi
2. Dritan Prençi
3. Vladimir Mara
4. Dorina Bejko

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektvendimeve individuale për secilin prej tre prokurorëve të renditur të parët.

Z. Ibrahim hedh në votim projektvendimet.



Miratohen me 9 vota pro

(Vendimet nr.125, 126, 127, 128, datë 19.05.2020, gjenden të protokolluara në dosjen e seancës dhe të publikuara në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Ibrahimi theksoi në përfundim të mbledhjes, se Këshilli mori sot një vendim të rëndësishëm lidhur me ecurinë e punës së SPAK-ut, duke e çuar numrin e prokurorëve deri tani, në 12 nga 15 gjithsej që parashikon struktura.

Ai bëri edhe një kujtesë për organet e vetingut, për të përshpejtuar procesin e vlerësimit kalimtar për tre kandidatët e fundit për në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)



KRYETARI

Gent Ibrahimi

Shënim: Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjitha procedurave të rishikimit.

Në këtë procesverbal janë/nuk janë vënë re dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 12/06/2020
Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi

